



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 121, Datë 19.06.2024**

**MBI**

**RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “GSA” SH.P.K. NË VEPRIMTARINË E  
FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “ç”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “d”, 5, pika 1, gërma “d”, 13, dhe 16 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.06.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1083/5 prot., datë 14.06.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “GSA” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 102, datë 21.12.2009, rinovuar me vendimin nr. 84, datë 16.09.2014 dhe rinovuar sërish me vendimin e bordit të ERE-s nr. 127, datë 13.08.2019”,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “GSA” sh.p.k., me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 1083 prot., datë 14.05.2024 dhe nr. 1083/1 prot., datë 22.05.2024, ka paraqitur kërkesën për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 99, datë 27.05.2024 vendosi të fillojë procedurën për rinovimin e licencës nr. 246, Seria FK14 të shoqërisë “GSA” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. nr. 102, datë 21.12.2009, rinovuar me vendimin nr. 84, datë 16.09.2014 dhe rinovuar sërish me vendimin e bordit të ERE-s nr. 127, datë 13.08.2019.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 29.05.2024 dhe 30.05.2024) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 07.06.2024), nuk rezultoi të ketë të tilla. Ky njoftim u publikua dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Me shkresën me nr. 1083/4 prot., datë 03.06.2024, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar vendimin e bordit mbi fillimin e procedurave për rinovimin e licencës nr. 246, Seria FK14 në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të Aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar.
- Shoqëria ka shlyer ndaj ERE-s të gjitha detyrimet për sa i përket pagesave të rregullimit.
- Nga shqyrtimi i aplikimit, rezulton se shoqëria ka plotësuar tërësisht dokumentacionin e kërkuar.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të rinovojë licencën e shoqërisë “GSA” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 23.12.2024.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**